

Shtojca III
Formulari i Raportimit Vjetor

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA E KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA JENK/OPÇINA JENK/MUNICIPALITY OF JENK

02/Nr. Prot. 1-180/648
Nr. i faq. 3
Data 27/01/2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



FORMULAR I RAPORTIMIT VJETOR

FRV: 01/2026

Lidhur me Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike

* Ky raport i dorëzohet Agjencisë për Informim dhe Privatësi, përues zyrtar të përgjegjës për qasje në dokumente publike të institucionit publik, në të largu, në dritën e fundit të muajt janar të çdo viti. Raportimi bëhet për periudhën janar - dhjetor të vitit paraprak.

INSTITUCIONI RAPORTUES: Komuna Junik

Raport Vjetor: Janar- Dhjetor 2025.

Zyrtari Përgjegjës¹ për Qasje në Dokumente Publike në Institucionin tuaj:
(Emri, mbiemri, adresa e postës elektronike, nr. tel:)

Qëndrim Knushi. qendrim.knushi@rks-gov.net, tel: 044-270-865.

Zyrtari Përgjegjës² [ZKA] në Institucionin tuaj: (Emri, mbiemri, adresa e postës elektronike, nr. tel:)

Ruzhdi Shehu

Data e dorëzimit:

27.01.2026.

Të Dhënat Lidhur me Kërkesat

Tabela nr. 1

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Kërkesat e aprovuara plotësisht	Kërkesat e aprovuara pjesërisht	Kërkesat e refuzuara
8	8	0	0

Qëndrim Knushi

¹ zyrtar administrativ në kuadër të institucionit publik, i caktuar për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave;

² zyrtari më i lartë administrativ i institucionit publik sikurse është përcaktuar, i cili është përgjegjës për vendimmarrje në kuadër të një institucioni publik;
Ruzhdi Shehu

Vendimet për Refuzim dhe Arsyet

Tabela nr. 2

Numri i vendimeve të lëshuara për refuzim	0
Arsyet e Refuzimit dhe Qasjes së Kufizuar	Numri
mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe të sigurisë publike	0
sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare	0
parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit	0
hetimeve disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;	0
inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar	0
të drejtës për privatësi dhe e drejta e fshirjes ('E drejta për t'u harruar')	0
konfidencialitetit komercial, siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë	0
dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale	0
politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit	0
konfidencialitetit statistikor	0
barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë	0
diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën dokument të klasifikuar	0
kërkesës së paqartë	0
arsyeve tjera (specifiko):	0

Profili i Aplikuesve dhe Dokumentet e Kërkuara

Tabela nr. 3

Profili	Numri
Mediune	0
OJQ	6
Individë	2
Të tjerë	0

Tabela nr. 4

Dokumenti	Numri
Shpenzim i parasë publike	1
Dokumente administrative	2
Dokumente ligjore dhe nënligjore	
Statistika	2
Dokumente lidhur me ushtrimin e funksioneve publike	1
Dokumente lidhur me marrëdhënien e punësimit	1
Dokumente lidhur me ambientin	1
Tjera	

Pyetësor për komunat mbi planet dhe strukturat për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Eficiencën e Energjisë

Komuna e JYNIKUT

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNITETI I JYNIKUT/JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
QZ/No. Prot.	1-180/10093
No. ifaq.	3
Data	14/11/2025

I. Plane Strategjike dhe Dokumente të Detyrueshme

1. A ka komuna juaj **Plan për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm**?
☐ Po ☒ Jo

Draft

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

2. A ka komuna juaj **Program për Mbrojtjen e Natyrës** në territorin e vet, në harmoni me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin?
☐ Po ☒ Jo

jo

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

3. A është hartuar dhe miratuar **Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit** (nëse në territor ka ndotje mbi vlerat kufitare)?
☐ Po ☒ Jo

Jo

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

4. A ka komuna juaj **Plan Komunal për Energji dhe Klimë**?
☒ Po ☒ Jo

jo

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

A ka komuna juaj **Plan Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (EEAP)?**

☒ Po ☐ Jo

po

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

A ka komuna juaj **Plan Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave?**

☒ Po ☐ Jo

po,

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

☐ Po ☐ Jo

5. A ka komuna juaj **Plan për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri?**

☐ Po ☒ Jo

jo

Nëse Po, ju lutem bashkëngjitni kopjen ose linkun:

II. Strukturat dhe Zyrtarët Komunalë

8. A ka komuna juaj **Zyrë Komunale për Energji** të funksionalizuar me staf të kualifikuar?

☐ Po ☒ Jo

9. A ka komuna juaj **Inspektor Mjedisor** të emëruar?

☒ Po ☐ Jo

10. A ka komuna juaj **Zyrtar / Njësi për Eficiencë të Energjisë?**

☐ Po ☒ Jo

Jo i veqante, zyrtar për PTK dhe KEK

11. A ka komuna juaj **njësi / person përgjegjës për raportimin e të dhënave mbi cilësinë e ajrit?**

☐ Po ☒ Jo

III. Buxheti

16. A ndan komuna buxhet të veçantë për **mbrojtje të mjedisit**

☒ Po ☐ Jo

Jo të veqante. Kontartat për pasttim të rrugeve, kater here në vit

Nëse Po, ju lutem shënoni buxhetin e ndarë për vitin 2025:

17. A ndan komuna buxhet të veçantë për **eficiencë të energjisë dhe kursime në ndërtesat publike?**

☒ Po ☐ Jo

Nëse Po, ju lutem shënoni buxhetin e ndarë për vitin 2025:

Falemnderit për kohën tuaj

Kerkese per qasje ne te dhena publike

Agron Demi <agron@atlas.org>

Mon 11/10/2025 12:21 PM

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JENIK/OPSTINA JENIK/MUNICIPALITY OF JENIK	
01/Nr. Prot.	1-155/9906
Nje. Org	1
Nr. i faq.	1
Data	11/11/2025

To: Zenun Shala <zenun.shala@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;

Cc: Andina Vllahu <andina@atlas.org>; Vlera Curri <vleracurri@gmail.com>;

1 attachments (69 KB)

Pyetesori.docx;

K-8

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Te nderuar

Shpresoj se ky email ju gjen mire me pune dhe shendet.

Jam Agron Demi dhe po ju shkruaj nga Instituti Atlas.

Bashkangjitur me kete email po e percjell nje pyetesor qe ka te beje me marrjen e disa informatave nga fusha e mjedisit, eficiences se energjise dhe inspektorateve.

Mbetem shume me shprese se do marrim pergjigje gjate kesaj jave.

Nese ju duhen info shtese, ju lutem mos hezitoni te me shkruani apo me kontaktoni ne kete numer te tel 049609704.

Me respekt,
Agron


--
Agron Demi

CEO of Atlas Institute

+38349609704

agron@atlas.org

www.atlas.org



Njoftim për Kërkesën për Qasje në Dokumente Zyrtare – Kontrata "Asfaltimi i rrugëve lokale"



Imer Gjota

Today, 5:16 AM

Qendrim Knushi; Ruzhdi Shehu

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	1-18018935
Një. Org.	1
Nr. i llog.	1
Data	10/10/2025

Reply all |

Inbox

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 10/9/2030 5:16 AM

P. 7.

Të nderuar,

Sipas kërkesës për qasje në dokumente zyrtare lidhur me kontratën për **Asfaltimin e rrugëve lokale në Junik** (rr. Shkëlzen Gacaferi, rr. e Gështenjave, rr. Avdyl Shala, rr. Ali Bajraktari, rr. Brahim Sadiku, rr. Fadil Maloku, rr. Avdullah Salihu, rr. Mbretëresha Teutë, rr. Dardania - Ritender), dhe në bazë të komunikimit me përfaqësuesen e projektit për Auditim Social, ju konfirmojmë se dokumentacioni i kërkuar është në dispozicion të parashtruesit të kërkesës.
 Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt,

Imer Gjota

UD Menaxher i Prokurimit
 Komuna Junik
 tel: +38349197196
 E-mail: imer.gjota@rks-gov.net

			
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA			
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK			
01/Nr. Prot.	11. 155/8101		
Një. Org	1		
Nr. i faq.	1		
Data	15/09/2025		

KËRKESE PËR QASJE NË DOKUMENTE ZYRTARE

E nderuara Komuna e Junikut,

K-7

Shoqata "Jeta" dhe Instituti KLGI, bazuar në aktivitetet që po zhvillohen me mbështetjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në kuadër të projektit për auditimin social në komuna. Proces që është duke u zbatuar në gjashtë (6) komuna të Kosovës, përfshirë edhe Komunën e Junikut, me fokus në një (1) projekt të përzgjedhur nga financimi i Skemës së Grantit të Performancës Komunale.

Në kuadër të projektit për auditim social, ju drejtohen me këtë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare që lidhen me projektin "Asfaltimi i rrugëve lokale", i cili është financuar në kuadër të Grantit të Performancës.

Kërkojmë që të na mundësoni qasje dhe kopje të dokumenteve përkatëse, që nga faza e planifikimit e deri tani ku ka arritur implementimi.

Auditimi do të realizohet nga Grupi Lokal i Auditimit Social, përbërjen e të cilit grup e keni pranuar mëheret përmes Emaili.

Qasja në këto dokumente është e domosdoshme për realizimin e auditimit social dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Me respekt,

Shoqata "Jeta" & Instituti KLGI

FW: Përgjigje lidhur me ngrohjen e shkollave në Komunën e Junikut

6



Klodiana Pepshi


Today, 5:30 AM

Qendrim Knushi

Reply all |

Inbox

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 7/24/2030 5:30 AM



From: Klodiana Pepshi

Sent: Friday, July 25, 2025 10:59 AM

To: 'andina.vllahiu92@gmail.com' <andina.vllahiu92@gmail.com>

Cc: Xhavit Velijaj <Xhavit.Velijaj@rks-gov.net>

Subject: Përgjigje lidhur me ngrohjen e shkollave në Komunën e Junikut

Të nderuar nga Instituti Atlas,

Ju falënderoj për interesimin dhe për kontaktin tuaj lidhur me ngrohjen e shkollave në komunën tonë.

Në Komunën e Junikut kemi dy shkolla kryesore: Shkollën Fillore "Edmond Hoxha" dhe Gjimnazin "Kuvendi i Junikut".

Ju konfirmoj se:

- Shkolla Fillore "Edmond Hoxha" ngrohet kryesisht me pelet.
- Gjimnazi "Kuvendi i Junikut" ngrohet me dru.

Sa i përket shpenzimeve për ngrohje, nuk kemi vlera të sakta për momentin, pasi ato ndryshojnë gjatë vitit dhe varen nga faktorë të ndryshëm.

Aktualisht nuk përdoret thëngjill, naftë apo rrymë për ngrohjen e shkollave.

Nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme, jam në dispozicion për t'ju ndihmuar.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe për përkushtimin tuaj në promovimin e energjisë së pastër.

Me nderime,

Klodiana Pepshi

Zyrtare e lartë për Arsim

Komuna Junik

+383 46109810

Kërkesë | Ngrohja e shkollave

Andina Vllahiu <andina.vllahiu92@gmail.com>

Wed 7/23/2025 3:23 AM

To: Xhavit Velijaj <Xhavit.Velijaj@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;

Cc: agron.dm@gmail.com <agron.dm@gmail.com>;

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK		
01/Nr. Prot.	1- 155/5738	
Një. Org		
Nr. i faq.		
Data	24/07/2025	

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Përshëndetje të nderuar,

Shpresoj ky email ju gjen mirë!

Po ju shkruaj nga Instituti Atlas, misioni i të cilit është që Kosova dhe rajoni të kalojnë në energji të pastër, zvogëlojnë ndotjen dhe krijojnë një shoqëri të qëndrueshme dhe të drejtë. Ne do të nxisim këtë ndryshim duke promovuar politika, teknologji dhe angazhim të komunitetit që mundësojnë një botë më të pastër, më të shëndetshme dhe më të barabartë.


Përmes një projekti të cilin ne e kemi marrë, tash së fundmi, po ju kontaktojmë që të na udhëzoni t'i gjejmë të dhënat se si ngrohen shkollat në Komunën e Junikut: sa dhe cilat shkolla ngrohen me stufa, sa dhe cilat shkollat ngrohen me thëngjill, sa me naftë e sa me rrymë? Nëse keni të dhëna edhe sa është shpenzu në dru në metër kub e buxhet, si dhe sa thëngjill e naftë, e rrymë për ngrohjen e shkollave, edhe më mirë.

Shpresoj shumë në bashkëpunimin tuaj, dhe për çdo pyetje që mund të keni, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni në çdo kohë.

Ju faleminderit shumë paraprakisht!

Me nderime,

Andina Vllahiu
Analiste e Politikave
Atlas Institute



/59/4 REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	17.07.2025
REFERENC-Ë	01-155-5522
PËR/ZA/TO:	
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Zenun Shala - Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
NGA:	Flurije Shehu Kryeziu- Zyrtare e lartë për kadastër
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesë

I nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj numër 01-155-5522 datë 16.07.2025, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, jep këtë:

Përgjigje

Ne kemi analizuar kërkesën tuaj me kujdes, dhe kemi vërejtur se është bërë një keqkuptim.

Në historiatin e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis shihet se Aktvendimin e Kuvendit të Komunës së Deçanit – Sekretariatit për Veprimtari Shoqërore 05 numër 466-8 datë 27.03.1987, është si bazë përfitimit të pronës për Rasim Krasniqi e jo për palën për të cilin ju pretendoni. Po e citojmë pjesën nga historiatin ku shënohet akti që ju kërkon: "Në vitin 1987 parcela numër 1005/1 ndahet në 1005/1 dhe 1005/8. Parcela me numër 1005/1 me sipërfaqe 5405 m² mbetet në emër të pronarit të njëjtë d.m.th. Pronë Shoqërore Kuvendi komunal – Deçan, kurse parcela numër 1005/8 kalon në emër të Rasim Krasniqi (regjistri i ndryshimeve 2/1987), bazuar në Aktvendimin e Kuvendit të Komunës së Deçanit – Sekretariatit për Veprimtari Shoqërore 05 numër 466-8 datë 27.03.1987".

Nga kjo që u cek më lartë shpresojmë se është qartësuar se akti: Aktvendimin e Kuvendit të Komunës së Deçanit – Sekretariatit për Veprimtari Shoqërore 05 numër 466-8 datë 27.03.1987, nuk është bazë për ndryshimet pronësore për Hysni(Azem) Eminaj.

Në bazë të shënimeve ekzistuese kadastrale shihet se e vetmja bazë e fitimit të pronësisë në parcelën numër 1351 është aeroinqizimi, kjo drejtori nuk posedojnë me ndonjë akt tjetër juridik, shif historiatin numër 06-941/3759 datë 23.06.2025.

1. Bashkëngjitur: Kopje e historiatit 06-941/3759 datë 23.06.2025

Gjithë të mirat!



AVOKAT - LAWYER

Budak H.Shala

Rr. "Mbretëresha Teutë", pn, Pejë

Mob: +38349766719, Email: budakshala@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	01-125-5522
Një. Org.	1
Nr. i faq.	1
Data	16/07/2025

KOMUNËS SË JUNIKUT

z.Qëndrim Knushi, Zyrtarë përgjegjës për qasje në dokumenta publike

Kërkesë për qasje në dokumenta publike

I nderuar si i autorizuar i Hysni (Azem) Eminaj ju drejtohem më kërkesë për qasje në dokumenta publike dhe atë sigurimin e kopjes fizike të Aktvendimit të Kuvendit të Komunës së Deçanit- Sekretariatit për veprimtari Shoqërore, 05 numër 466-8 datë 27.03.1987.

Më autorizimin e palës Hysni (Azem) Eminaj jam angazhuar për ceshtje e pronësisë, dhe me datën 23.06.2025 kemi prnauar Historiatin nga Komuna e Junikit, Drejtoria për Urbanizem, Kadaster dhe Mjedis, ku kemi kuptuar qe Aktvendimi i cekur është një akt i cili është marrur për bazë për ndryshimet pronësore.

Andaj ne kuptim të nenit 10, të Ligjit Nr. 06/L-08, Ligji për qasje në dokumentet publike ju drejtohem me këtë kërkesë, duke vlersuar se e kemi të drejtën e qasjes në këtë Akt administrative, dhe po ashtu kemi interesë juridikë, po ashtu pres përgjigje nga ana juaj në afatin e përcaktuar në nenin 12 të po kemi ligji.

Pejë, 11.07.2025

Me Respekt


Av. Budak H.Shala

AVOKAT - LAWYER

BUDAK H. SHALA

Tel: 049/766-719

budakshala@hotmail.com



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Për:	z. Edonis Hykosmoni
Nga:	Komuna e Junikut
Lënda:	Përgjigje në Kërkesë nr. 1-155/3896 të datës 29.05.2025
Data:	09.06.2025

Komuna e Junikut, ka pranuar dhe shqyrtuar me kujdes kërkesën tuaj të datës 29.05.2025, me numër protokolli 1-155/3896, lidhur me kërkesën për qasje në dosjet e kandidatëve RAN0121989 dhe RAN0117107, të cilët kanë aplikuar në konkursin RN00017614 për pozitën Zyrtar i Logjistikës.

Ndonëse Komuna e Junikut është e përkushtuar ndaj parimeve të transparencës dhe qasjes në dokumente publike, siç përcaktohet nga Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, duhet të theksojmë se kjo e drejtë nuk është absolute dhe kufizohet aty ku preket privatësia e individëve dhe mbrojtja e të dhënave personale.


Dosjet e kandidatëve, duke përfshirë diplomat universitare, përvojën e punës dhe dokumentet mbështetëse, përmbajnë të dhëna personale të ndjeshme. Qasja në këto dokumente ndalohet rreptësisht nga Ligji Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Sipas këtij ligji, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave personale duhet të bëhet vetëm me pëlqimin e individit ose në bazë të një detyrimi ligjor. Dhënia e qasjes në dokumentet e kandidatëve të tjerë, pa pëlqimin e tyre dhe pa një bazë të qartë ligjore, do të përbënte shkelje të rëndë të të drejtës së tyre për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Gjithashtu, Rregullorja (QRK) Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, e cila rregullon procesin e rekrutimit në shërbimin civil, nuk parashikon asnjë dispozitë që i jep të drejtë kandidatit të kërkojë qasje në dokumentet e aplikantëve të tjerë. Kjo rregullore fokusohet në transparencën e procesit të vlerësimit të kandidatëve, publikimin e listave të kandidatëve të kualifikuar dhe rezultateve përfundimtare, por gjithmonë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për pasojë, Komuna e Junikut nuk mund ta aprovojë kërkesën tuaj për qasje në dosjet e kandidatëve RAN0121989 dhe RAN0117107, pasi një veprim i tillë do të binte ndesh me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe parimet e mbrojtjes së privatësisë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kandidati i pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.

Junik,
09.06.2025



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 1-155/3896
Një. Org. 1
Nr. i llog. 8
Data 29/05/2025

Junik, 29.05.2025

Nga: Edonis Hykosmoni

Për: Komuna e Junikut

Lënda: Kërkesë për qasje në dokumente publike

K-4

Të nderuar,

Shpresoj të jeni mirë.

Ju shkruaj me qëllim të parashtrimit të kësaj kërkesë për qasje në dokumente publike. Në këtë linjë, ju lutem që, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (tash e tutje referuar si "Ligji për Qasje në Dokumente Publike"), të më mundësoni qasje në:

- Dosjen e kandidatit RAN0121989 dhe RAN0117107 të cilët kanë aplikuar në konkursin RN00017614 për pozitën Zyrtar i Logjistikës, (shih të bashkëngjitur);

Dosja më sipër të jetë e plotë duke përfshirë: diplomat universitare, përvoja e punës dhe dokumentet mbështetëse gjatë kandidimit.

Kjo kërkesë për qasje në dokumente publike bazohet në Nenin 10 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Ju lutem që përgjigjen të ma dërgoni përmes emailit në ehykosmoni@gmail.com brenda afatit ligjor i cili parashihet me Nenin 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Për fund, ju lutem që të më konfirmoni regjistrimin e kësaj kërkesë, si dhe numrin e protokolit.

Faleminderit paraprakisht për kohën tuaj.

Me respekt,


Edonis Hykosmoni

- Bashkëngjitur konkursi publik; dhe
- Njoftimi i datës 22.05.2025 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve që kanë plotësuar kushtet për të kaluar në fazën tjetër

Për: Zyrën për Informim, Komuna e JUNIKUT

Nga: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Data: 14 Janar 2025

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	1-155/2059
Një. Org	
Nr. i faq.	7
Data	24/03/2025

Kërkesë për qasje në dokumente publike

I nderuar z. Knushi

Konsorciumi i organizatave të shoqërisë civile Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT), e udhëhequr nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 12 organizata tjera partnere të shoqërisë civile: 1. Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy - QPA, 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skenderaj - IQS, 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit, po vazhdojnë me monitorimin dhe vlerësimin e transparencës në institucione lokale konkretisht në verifikimin e indikatorëve të transparencës komunale për periudhën janar – dhjetor 2024. Si rezultati i këtij angazhimi të përbashkët, do të publikohet **“Transparimet komunal - 2024”** i cili bazohet në 48 indikatorë vlerësues dhe do të përfshinë 38 Komunat e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të informimit dhe validimit të disa indikatorëve vlerësues, AQT kërkon nga ana e komunës qasje në disa informata sipas të drejtës për qasje në dokumente publike. Këto informata, do t'i shfrytëzohen në funksion të marrjes së informatës dhe validimit të indikatorëve të caktuar për komunën e Juaj.

Ju lutemi që pasi t'i plotësoni përgjigjet në pyetjet e paraqitura më poshtë, të njëjtin dokument të na përcillni në e-mail: rrjetiqelizagjakove@gmail.com dhe në bramadanaj@kdi-kosova.org sipas afatit ligjor për qasje në dokumente publike.

Nëse keni nevojë për sqarime shtesë ju lutem mos hezitoni të na shkruani apo të na kontaktoni në numrin: +383 44 188 336

Pyetjet të cilat kërkojnë përgjigjen tuaj janë të paraqitura më poshtë:

Pyetja 1: Sa rregullore ka draftur Komuna juaj kete vit? A ka pasur publiku qasje në draft rregulloret Kuvendit Komunal dhe a janë të publikuara në ueb faqen e komunës, rregulloret komunale të miratuara gjatë periudhës janar- dhjetor 2024?

Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:

Draft materiali https://kk.rks-gov.net/junik/?page_id=200004345 zgjedh 2024 :

1. <https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2024/09/Rregullorja-per-Taksa-Ngarkesa-dhe-Gjoba-komunale-2025-Leximi-i-pare.pdf>
2. <https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2025/01/Draft-Model-Rregullore-pe%CC%88r-transparence%CC%88-komunale-24.pdf>

Komuna e Junikut ka draftuar 2 te miratuara rregullore:


RE: Kërkesë për informacion lidhur me Konsultimin Publik - 2024

Rrustem Pepshi

Wed 3/26/2025 9:49 AM

To: Kosovo Local Government Institute <klg.institute@gmail.com>;

Cc: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Zeqë Hebibi <Zeqë.Hebibi@rks-gov.net>; Liberta Hoxha <liberta.f.hoxha@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;



4 attachments (5 MB)

Formulari per Pyetje_Junik.docx; Junik - Databaza - Transparometri 2024.xlsx; Dëshmi për përmirësimin e të dhënave.pdf; KERKESA PER QASJE NE DOKUMENTE ZYRTARE - TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2024 - Komuna JUNIK (003).docx;

P-3

Të Nderuar,

Ashtu siç diskutuam në telefon, ju lutem më lejoni t'ju përgjigjem pyetjeve që keni parashtruar. Në bashkëngjitje, gjeni të dhënat e plotësuara me përgjigjet "po" dhe "jo", si dhe dëshmi për të shmangur dublikimin e të dhënave që kemi dërguar në KDI.

Me respect
Rrustem Pepshi

From: Kosovo Local Government Institute <klg.institute@gmail.com>
Sent: Thursday, March 13, 2025 10:50 AM
To: Rrustem Pepshi <rrustem.pepshi@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për informacion lidhur me Konsultimin Publik - 2024

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Rrustem Pepshi
Zyrtar Përgjegjës për Konsultime Publike
Junik, Republika e Kosovës

I nderuar, z. Pepshi,

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale është duke zhvilluar monitorimin e konsultimit publik në nivelin lokal për vitin 2024. Përgjatë periudhës Dhjetor 2024 – Shkurt 2025, janë mbledhur të dhënat nga ueb faqet komunale mbi zbatimin e konsultimit publik, bazuar në Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna.

Për të dhënat që nuk është arritur të mblidhet informacion (dokumente) të publikuara në ueb faqe. Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, referuar nenit 12. Afateve për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, bazuar në pyetjet e listuara, presim të marrim informacionin e plotë.

Duke marrë parasysh angazhimet tuaja, ju lutem që brenda afatit ligjor, të na i dërgoni informacionet përmes e-mailit, duke e bërë kopje (Cc) edhe info@klgi-ks.com.

Këto të dhëna, do të bëhen pjesë e vlerësimit në raportin e monitorimit për vitin 2024, si dhe vlerësimit për rangimin e komunave, për të gjitha informatat na i bashkëngjitni linqet e publikimeve në ueb faqe apo platformën



RRJETI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE AVONET
NETWORK OF NGOS AVONET

18 mars 2025

Z. Ruzhdi Shehu
Kryetar
Komuna e Junikut

Kërkesë për qasje në dokumente dhe informacion
Ref: 106/2025

P.2

I nderuar Z. Ruzhdi Shehu,

Bazuar në ligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, ju shkruaj këtë kërkesë, ku përmes kësaj ju kërkoj qasje në dokumentet tuaja publike, të lëshuara apo të poseduara nga institucioni juaj si person juridik dhe mekanizmat tuaj.

AVONET është duke monitoruar dhe hulumtuar aktivitetet e prokurimit në nivel të Republikës së Kosovës. Gjatë monitorimit të këtyre aktiviteteve, kemi identifikuar një dokument *Letër Referencë*, të datës 21.05.2024, të lëshuar nga QKMF – Junik, e nënshkruar nga znj. Saranda Isufaj, për KosovaMed Healthcare sh.p.k. – Prishtinë (keni të bashkangjitur).

Dokumentet në të cilat kërkojmë qasje përfshijnë (ju lutemi të na konfirmoni):

1. A është ky dokument i lëshuar nga institucioni i Komunës së Junikut?

Shënim: Përgjigjjet nga kjo kërkesë kërkojmë të i marrim brenda afateve të parapara në ligjin për qasje në dokumente publike.

Me respekt,

Kenan Gashi
Drejtör Ekzekutiv
Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET

KENAN GASHI
DREJTOR EKZEKUTIV

AVONET.RKS@GMAIL.COM
+383 44 800 114



ZYRA E DREJTORIT
EKZEKUTIV

RAMADAN REXHEPI P.N.
FERIZAJ 70000

RRJETI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE AVONET

NETWORK OF NGOS AVONET

06.03.2025

z. Ruzhdi Shehu
Kryetar
Komuna e Junikut

	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNK/OPŠTINA JUNK/MUNICIPALITY OF JUNK		
01/Nr. Prot.	4-155/1607	
Një. Org		
Nr. i faq.		
Data	07.03.2025	

Kërkesë për qasje në dokumente dhe informacion
Ref: 91/2025

K-2

I nderuar z. Ruzhdi Shehu,

Bazuar në ligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, ju shkruaj këtë kërkesë, ku përmes kësaj ju kërkoj qasje në dokumentet tuaja publike, të lëshuara apo të poseduara nga institucioni juaj si person juridik dhe mekanizmat tuaj.

Dokumentet në të cilat kërkojmë qasje përfshijnë:

1. Kontratën e nënshkruar të aktivitetit të prokurimit me titull: Shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator në QKMF – Junik, me nr. të prokurimit: 636-23-7653-2-1-1.
2. Deri më datën 27.05.2024, a ka qenë aktive kjo kontratë?
3. Sa është shpenzuar vlera e kontratës deri më 27.05.2024?

Shënim: Përgjigjet nga kjo kërkesë kërkojmë të i marrim brenda afateve të parapara në ligjin për qasje në dokumente publike.

Me respekt,


Kenan Gashi
Drejt看 Ekzekutiv
Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET

Përgjigje në Kërkesen per casje ne dokumentet zyrtare - KDI -
Kërkesë për qasje në dokumente publike - Transparometri Komunal
2024 - Junik

Rrustem Pepshi

Mon 1/20/2025 11:09 AM

To: rrjetiqelizagjakove@gmail.com <rrjetiqelizagjakove@gmail.com>;



Cc: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Besnik Ramadanaj (KDI-TI Kosova) <bramadanaj@kdi-kosova.org>; Selviye Kurti (KDI-TI Kosova) <skurti@kdi-kosova.org>; Zeqe Hebibi <Zeqe.Hebibi@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;

2 attachments (965 KB)

KERKESA PER QASJE NE DOKUMENTE ZYRTARE - TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2024 - Komuna JUNIK (003).docx; TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2024 - Lista e indikatoreve.pdf.docx;

Të nderuar,

P - 1

Ju lutem pranoni përgjigjet e kërkuara për qasje në dokumentet zyrtare të bashkangjitura me titullin "KËRKESA PËR QASJE NË DOKUMENTE ZYRTARE - TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2024 - Komuna JUNIK (003)". Disa ditë më parë kemi dërguar edhe një dokument të plotësuar me të gjitha pyetjet ku janë edhe disa pyetje nga kërkesa juaj, por ne jemi përgjigjur edhe një herë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se pyetja 4 dhe pyetja 20 janë identike. A mos keni pasur ndonjë pyetje tjetër dhe ka ikur si gabim? Pyetja 4: A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tremujore në Kuvend? Pyetja 20: A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tremujore në Kuvend?

Ju informojmë se webfaqet në muajin shtator janë migruar nga webfaqet e vjetra tek të rejtat dhe kemi pasur një numër të madh dokumentesh gjatë migrimit të cilat kanë humbur dhe na është dashur që t'i ripublikojmë. Të gjitha dokumentet e nevojshme janë publike dhe të qasshme në linqet e dërguara.

Sidoqoftë, ne ju falënderojmë dhe jemi të gatshëm për çdo lloj bashkëpunimi, duke ju uruar suksese në vlerësim.

Me respect
Rrustem Pepshi
Zyra per Informim
+38344719046

Për: Zyrën për Informim, Komuna e JUNIKUT

Nga: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Data: 14 Janar 2025

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	1-155/447
Një. Org	
Nr. i faq	4
Data	14/01/2025

Kërkesë për qasje në dokumente publike

I nderuar z. Knushi

K-01

Konsorciumi i organizatave të shoqërisë civile Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT), e udhëhequr nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 12 organizata tjera partnere të shoqërisë civile: 1. Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy - QPA, 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skenderaj - IQS, 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit, po vazhduon me monitorimin dhe vlerësimin e transparencës në institucione lokale konkretisht në verifikimin e indikatorëve të transparencës komunale për periudhën janar – dhjetor 2024. Si rezultati i këtij angazhimi të përbashkët, do të publikohet **“Transparimet komunal - 2024”** i cili bazohet në 48 indikatorë vlerësues dhe do të përfshinë 38 Komunitet të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të informimit dhe validimit të disa indikatorëve vlerësues, AQT kërkon nga ana e komunës qasje në disa informata sipas të drejtës për qasje në dokumente publike. Këto informata, do t'i shfrytëzohen në funksion të marrjes së informatës dhe validimit të indikatorëve të caktuar për komunën e juaj.

Ju lutemi që pasi t'i plotësoni përgjigjet në pyetjet e paraqitura më poshtë, të njëjtin dokument të na përcillni në e-mail: rrjetiqelizagjakove@gmail.com dhe në bramadanaj@kdi-kosova.org sipas afatit ligjor për qasje në dokumente publike.

Nëse keni nevojë për sqarime shtesë ju lutem mos hezitoni të na shkruani apo të na kontaktoni në numrin: +383 44 188 336

Pyetjet të cilat kërkojnë përgjigjen tuaj janë të paraqitura më poshtë:

Pyetja 1: Sa rregullore ka draftur Komuna juaj kete vit? A ka pasur publiku qasje në draft rregulloret Kuvendit Komunal dhe a janë të publikuara në ueb faqen e komunës, rregulloret komunale të miratuara gjatë periudhës janar- dhjetor 2024?

Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:

Pyetja 2: A janë të publikuar procesverbalet e seancave të Kuvendit Komunal dhe rezultatet e votimit të pikave të rendit të ditës?

**VEREJTJE: Në ueb nuk janë gjetur të gjitha procesverbalet - <https://kk.rks-gov.net/junik/?page=2024>*

Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë: